

KREU VI

PPSH NË LUFTË PËR NDËRTIMIN E PLOTË TË SHOQËRISË SOCIALISTE NË KUSHTET E BLLOKADËS IMPERIALISTO-REVIZIONISTE

(1961-1965)

1. KONGRESI IV I PARTISË. ORIENTIMI PËR NDËRTIMIN E PLOTË TË SHOQËRISË SOCIALISTE

Kongresi IV i Partisë i zhvilloi punimet e tij në Tiranë prej 13 deri 20 shkurt 1961. Në Kongres merrnin pjesë 754 delegatë me votë deliberative dhe 54 delegatë me votë konsultative që përfaqësonin 50 802 anëtarë dhe 2 857 kandidatë për anëtarë partie.

Kongresi bëri bilancin e shndërrimeve ekonomiko-shoqërore, përcaktoi orientimet në etapën e re të ndërtimit socialist të vendit dhe pranoi direktivat e planit të 3-të pesëvjeçar.

Ndërtimi i bazës ekonomike të socializmit

Me shndërrimin në pronë të përbashkët shoqërore të mjeteve kryesore të prodhimit e të qarkullimit dhe me përfundimin në përgjithësi të kooperimit socialist të bujqësisë u zhduk në përgjithësi ekonomia shumëformëshe dhe në vend të saj u krijua një sistem i vetëm socialist i ekonomisë. Në vitin 1960 sektori socialist përfshinte 99 për qind të prodhimit të përgjithshëm industrial, 80 për qind të prodhimit të përgjithshëm bujqësor, 100 për qind të tregtisë me shumicë, 90 për qind të tregtisë me pakicë. Afro 90 për qind të të ardhurave kombëtare u krijuan nga

sektori socialist. Kongresi IV i Partisë, duke u mbështetur në këto ndryshime rrënjësore ekonomiko-shoqërore, nxori konkluzionin se në RPSH ishte ndërtuar baza ekonomike e socializmit si në qytet ashtu edhe në fshat.

Me fitoren e marrëdhënieve socialiste në prodhim, u zhdukën klasat shfrytëzuese, si klasë, dhe shfrytëzimi i njeriut prej njeriut.

Tipari më karakteristik dhe themelor i strukturës së klasave të vendit tonë në etapën e sotme, — vuri në dukje Kongresi, — është ekzistenca e dy klasave mike, e klasës punëtore dhe e fshatarësisë kooperativiste, aleanca e tyre nën udhëheqjen e klasës punëtore dhe forcimi mbi këtë bazë i unitetit të popullit.¹

Marrëdhëniet midis këtyre klasave tani dalloheshin si marrëdhënie bashkëpunimi vëllazëror e të ndihmës shoqërore midis punonjësve të çliruar nga çdo lloj shfrytëzimi.

Në vitin 1960, punëtorët së bashku me familjet e tyre përbënin 22,5 për qind të numrit të përgjithshëm të popullsisë, fshatarësia punonjëse 62,8 për qind dhe inteligjencia popullore 13,6 për qind.

Krijimi i sistemit socialist të ekonomisë në qytet e në fshat solli me vete forcimin e bazës ekonomiko-shoqërore të diktaturës së proletariatit, të demokracisë socialiste dhe të unitetit Parti-popull.

Shndërrimet e mëdha ekonomiko-shoqërore, puna për ndërtimin socialist, veprimtaria e gjithanshme edukuese e Partisë bënë që të ndryshonin në mënyrë të dukshme edhe figura morale e njeriut punonjës, ndërgjegjja, psikologjia e tij ndaj punës e pronës shoqërore, ndaj shoqërisë dhe familjes. Ideologjia socialiste, si ideologjia sunduese, vepronte tani me një forcë më të madhe për shndërrimin e mëtejshëm socialist të shoqërisë, të ndërgjegjes së njerëzve dhe të jetës së tyre materiale.

Vendosja e marrëdhënieve socialiste në prodhim hapi perspektiva të mëdha për zhvillimin e vrullshëm të forcave prodhuese dhe për forcimin e fuqisë mbrojtëse të vendit.

¹ Rezolucioni i Kongresit IV të PPSH. Dokumente kryesore të PPSH, vëll. III, f. 532.

Për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste

Me ndërtimin e bazës ekonomike të socializmit, Shqipëria hyri në një etapë të re historike të revolu-

lucionit. Në këtë etapë u përcaktua si qëllim strategjik ndërtimi i plotë i shoqërisë socialiste. Kongresi IV i Partisë përcaktoi orientimet e zhvillimit të vendit në këtë etapë.

Si detyrë themelore e kësaj etape u caktua ndërtimi i plotë i bazës materialo-teknike të socializmit, duke zhvilluar në një shkallë të re më të lartë forcat prodhuese. Hapat e para për ndërtimin e bazës materialo-teknike të socializmit ishin bërë me shtetëzimet e mjeteve kryesore të prodhimit dhe me zhvillimin e ekonomisë socialiste në pesëvjeçarët e mëparshëm. Krijimi i saj i plotë, u dha orientim të bëhet në disa pesëvjeçarë të ardhshëm, gjatë të cilëve Shqipëria të shndërronhet nga një vend bujqësor-industrial në një vend industrialo-bujqësor.

Si hallkë kryesore për ndërtimin e plotë të bazës materialo-teknike të socializmit u përcaktua vazhdimi i industrializimit të vendit. Kongresi udhëzoi që edhe në të ardhmen industria socialiste të luante rolin drejtues në ekonominë popullore. Për zhvillimin e industrisë Kongresi porositi të përdorëshin kryesisht lëndët e para të siguruar në vend. Ai orientoi të vazhdohej t'i jepej vendi i parë industrisë së rëndë, prodhimit të mjeteve të prodhimit.

Krahas industrisë, u dha udhëzim të zhvillohej me ritme më të shpejta bujqësia, duke synuar zhdukjen e shpërpjesëtimit midis zhvillimit të këtyre dy degëve kryesore të ekonomisë popullore. Detyrë kryesore e bujqësisë mbeti rritja e prodhimit të drithërave për të siguruar bukën në vend. Njëkohësisht Kongresi kërkoi të shtoheshin edhe prodhimet e tjera bujqësore për të plotësuar më mirë kërkesat në rritje të popullsisë, nevojat e industrisë për lëndë të parë, si dhe për të shtuar eksportimin e tyre. Si rrugë kryesore e zhvillimit të bujqësisë u caktua rritja e vazhdueshme e rendimenteve, pa ndërprerë punën për hapjen e tokave të reja.

Me ngritjen e zhvillimin në një shkallë të lartë të forcave prodhuese u dha orientim të zhvilloheshin më tej e të përsoseshin vazhdimisht marrëdhëniet socialiste në prodhim.

Do të forcohej dhe do të zgjerohej prona shoqërore — baza e marrëdhënieve socialiste. Kjo do të arrihej nëpërmjet

rritjes, sipas mundësive, të akumulimit të brendshëm, kolektivizimit të ekonomive individuale fshatare në zonat malore, bashkimit të kooperativave të vogla në njësi më të mëdha, forcimit ekonomik dhe organizativ të kooperativave bujqësore, ruajtjes së pronës socialiste nga dëmtimet dhe shpërdorimet.

Kongresi dha udhëzim të përsosëj sistemi i punës me norma, të forcohej bashkëpunimi dhe ndihma ndërmjet degëve të ndryshme të prodhimit, ndërmarrjeve dhe kolektivave punonjëse, të përmirësohej sistemi i planifikimit, të përhapej në mënyrë të organizuar përvoja e përparuar.

Në lëmin e shpërndarjes, u dha orientim të përsosëshin: zbatimi i parimit të shpërblimit sipas sasisë dhe cilësisë së punës, përpjesëtimet në shpërndarjen e të ardhurave kombëtare (në fond akumulimi dhe përdorimi), si edhe përpjesëtimet midis fondeve të shpërndarjes individuale e shoqërore të përdorimit.

Mbi bazën e zhvillimit të pandërprerë të forcave prodhuese dhe të marrëdhënieve në prodhim do të rritej e do të forcohej klasa punëtore, do të çelikohej më tej aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë punonjëse nën udhëheqjen e klasës punëtore, do të ngrihej në mënyrë të pandalshme mirëqenia materiale dhe niveli kulturor i popullit.

Rëndësi shumë të madhe merrete në etapën e re të ndërtimit socialist edukimi komunist i punonjësve. «Ndërtimi i plotë i shoqërisë socialiste, — theksoi shoku Enver Hoxha, — nuk mund të kuptohet pa krijuar njëkohësisht edhe një njeri të ri, me ide e mendime të reja, me cilësi e virtyte të larta morale»¹.

Kongresi dha orientimin që lufta e Partisë për edukimin komunist të drejtohej në radhë të parë për një qëndrim thellësisht socialist ndaj punës e pronës shoqërore, për çrrënjosjen e koncepteve dhe të shprehive borgjeze e mikroborgjeze në ndërgjegjen e njerëzve, të paragjykimeve fetare, të bestytnive e zakoneve prapanike, për formimin e botëkuptimit shkencor materialist të punonjësit.

Tjetër detyrë kryesore ishte sigurimi i fitoreve të arritura dhe i fitoreve të reja në ndërtimin socialist kundër çdo

¹ Enver Hoxha. Raport në Kongresin IV të PPSH, Vepra, vëll. 20, f. 267.

orvatjeje për të dëmtuar ose për të asgjësuar këto fitore dhe për të rivendosur rendin çifligaro-borgjez.

Lidhur me këto u bë e qartë se me zhdukjen e klasave shfrytëzuese në vend, lufta e klasave nuk ishte shuar. Ajo do të zhvillohej e ashpër edhe gjatë etapës së ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste. Një rëndësi më të madhe merrte lufta klasore në frontin ideologjik. Kongresi theksoi se dobësimi ose pushimi i luftës së klasave, përgatit truallin për kundërrevolucion nga brenda dhe për ndërhyrje të armatosur nga jashtë, si rrjedhim, për rivendosjen e kapitalizmit.

Lufta e klasave brenda vendit ishte e domosdoshme të shikohej e lidhur ngushtë me luftën e klasave në arenën ndërkombëtare midis socializmit, popujve të shtypur e marksizëm-leninizmit, nga njëra anë, dhe imperializmit, reaksionit e revizionizmit, nga ana tjetër. Imperializmi dhe revizionizmi bënin presion të vazhdueshëm mbi PPSH dhe popullin shqiptar dhe nuk kishin hequr dorë nga synimet dhe orvatjet për të përmbysur rendin socialist në Shqipëri.

Për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste dhe për mbrojtjen e rendit socialist u quajt kusht i domosdoshëm forcimi e përsosja e vazhdueshme e diktaturës së proletariatit.

Në përputhje me kushtet e reja funksionet kryesore të shtetit socialist merrnin një zhvillim e përsosje të mëtejshme.

Funksioni ekonomik-organizues dhe kulturoro-edukues, të cilin shteti socialist shqiptar kishte filluar ta kryente që kur u ngrit, tani u thellua e mori një shtrirje më të gjerë në sferën e veprimtarisë shtetërore. Për të kryer si duhet këtë funksion u vu detyrë përmirësimi i metodës së drejtimit të ekonomisë e të kulturës nga organet e pushtetit popullor, përsosja e veprimtarisë së tyre planifikuese dhe organizuese.

Funksioni i shtetit për mbrojtjen e atdheut socialist mbetej po aq i rëndësishëm sa dhe më parë. Për këtë qëllim u vu detyrë rritja e fuqisë mbrojtëse të vendit, forcimi i Ushtrisë Popullore dhe i gjithë forcave të armatosura, përgatitja ushtarake sistematike e mbarë popullit.

Funksioni i shtypjes mbetej edhe pas zhdukjes së klasave shfrytëzuese një ndër funksionet kryesore të shtetit. Shtypja me mjete administrative drejtohej kundër mbeturinave të klasave shfrytëzuese dhe gjithë armiqtë të klasës, kundër agjentëve të imperializmit e të revizionizmit, kundër atyre që

cenonin rëndë pronën shoqërore shkëlnin ligjet e shtetit e normat morale të shoqërisë socialiste.

Ashtu si përpara, edhe në etapën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste Partia e Punës e Shqipërisë mbetej udhëheqësja dhe organizatorja e gjithë jetës së vendit. Lidhur me këtë, u shtrua si një detyrë e madhe e përhershme rritja e vazhdueshme e aftësive drejtuese, organizuese dhe edukuese të Partisë, forcimi i unitetit, i kalitjes ideologjike dhe i përbërjes së saj shoqërore.

Ndërtimi i bazës ekonomike të socializmit, ndryshimi i strukturës klasore të shoqërisë kishin bërë të domosdoshëm ndryshimin e neneve të Statutit të Partisë në lidhje me kushtet e pranimet në Parti. Kongresi IV i hoqi kërkesat e diferencuara sipas përbërjes shoqërore dhe vendosi një rregull të vetëm për të gjithë ata që kërkonin të pranoheshin në Parti. Heqja e kërkesave të diferencuara nuk donte të thoshte aspak që Partia të qëndronte e shkujdesur ndaj përbërjes shoqërore të të pranuarve. Ajo do të drejtonte e do të udhëhiqte me shumë kujdes, si gjithnjë, pranimet në Parti, duke shumuar radhët e saj me militantët më revolucionarë, më aktivë, më të lidhur me masat dhe më besnikë ndaj çështjes së Partisë e të popullit. Edhe në të ardhmen, shumicën dërrmuese të të pranuarve në Parti do ta përbënin njerëzit e prodhimit në qytet e në fshat, në radhë të parë punëtorët e industrisë, të minierave e të transportit, pastaj anëtarët e kooperativave bujqësore.

Direktivat e planit të 3-të pesëvjeçar

Direktivat e planit të 3-të pesëvjeçar 1961-1965 të zhvillimit ekonomik e kulturor

Kongresi i përpunoi në përputhje me orientimin për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste. Në këto direktiva u vu si detyrë kryesore: pesëvjeçari i 3-të të shënojë një hap të rëndësishëm përpara në ndërtimin e bazës materialo-teknike të socializmit; Shqipëria të ecë më shpejt në rrugën e shndërrimit nga një vend bujqësor-industrial në një vend industrialo-bujqësor; prodhimi bujqësor të shtohet me hapa më të mëdhenj dhe, si rrjedhim, të ngrihet më shumë niveli material dhe kulturor i masave punonjëse.

Vëllimi i përgjithshëm i prodhimit industrial parashikohej të rritej me një ritëm mesatar vjetor 8,7 për qind. Përparësi,

Orientimet
e planit 3.

si gjithnjë, do të kishte zhvillimi i industrisë së rëndë, sidomos industria nxjerrëse e përpunuese e mineraleve dhe e naftës.

Në bujqësi parashikohej të rritej prodhimi me një ritëm mesatar 15,5 për qind, duke i dhënë përparësi prodhimit të drithërave.

Për plotësimin e detyrave të planit do të investoheshin 51 për qind më shumë fonde se në pesëvjeçarin e dytë. Prej tyre, afër 82 për qind për degët prodhuese.

Parashikimet për rritjen e të ardhurave kombëtare, të pagës reale të punëtorëve e të nëpunësve si edhe të të ardhurave të fshatarësisë siguronin një ngritje të shënueshme të mirëqenies materiale e kulturore të punonjësve. Në mënyrë më të dukshme do të shtoheshin shpenzimet për sigurimet shoqërore, për pensionet, për arsim e për kulturë, për kopshtet e për çerdhet, kurse shërbimi mjekësor do të bëhej falas për të gjithë, edhe për fshatarësinë.

Plani i 3-të pesëvjeçar parashikonte të bëhej një kthesë në organizimin e arsimit popullor dhe të punës kërkimore për lidhjen më të ngushtë të shkollës dhe të shkencës me praktikën e ndërtimit socialist, me jetën. Në shkollat e mesme dhe të lartat do të përgatiteshin kadro në atë shkallë, sa të kalohej dyfishi i numrit që kishte më 1960.

Plotësimi i planit të 3-të pesëvjeçar mbështetej kryesisht në përdorimin e burimeve, të mjeteve dhe të forcave të brendshme, në rritjen e rendimentit të punës, në shfrytëzimin e plotë të aftësive prodhuese, në zbulimin dhe në shfrytëzimin e të gjitha rezervave, në pakësimin e humbjeve dhe në mënjanimin e shpenzimeve të kota etj. Njëkohësisht ai mbështetej edhe në ndihmën e vendeve socialiste, në bazë të marrëveshjeve që qenë përfunduar ose ishin në përfundim e sipër.

Pa luftuar revizionizmin nuk mund të luftohet me sukses imperializmi, nuk mund të ruhet uniteti në lëvizjen komuniste ndërkombëtare

Kongresi IV mbahej në kushtet e ashpërsimit të luftës midis marksizëm-leninizmit dhe revizionizmit në lëvizjen

komuniste ndërkombëtare.

Revizionizmi ishte bërë një rrezik shumë i madh dhe i drejtpërdrejtë për fitoret e mëdha historike që kishte arritur proletariati, për socializmin, për marksizëm-leninizmin. Revi-

zionizmit titist i qenë shtuar revizionizmi hrushovian dhe rryma të tjera. Ndryshe nga revizionizmi i vjetër i Bernshtajnit, i Kautskit dhe të tjerëve që rronte me lëmoshat e borgjezisë sunduese, revizionizmi modern ishte një revizionizëm në pushet, që kishte në dorë një fuqi të madhe ekonomike dhe ushtarake. Më e keqja ishte se ky revizionizëm qëndronte në krye të Bashkimit Sovjetik, shtetit të parë socialist, dhe të Partisë Komuniste të Leninit e të Stalinit. Kjo përbënte tragjedinë më të madhe që kishte njohur lëvizja komuniste ndërkombëtare. Ideologjia e përbashkët borgjeze si edhe shumë interesa të përbashkëta i kishin afruar dhe po i bashkonin gjithnjë e më tepër revizionistët modernë me imperialistët, me socialdemokratët dhe me gjithfarë shërbëtorësh të imperializmit në luftë kundër komunizmit, kundër revolucionit.

Revizionistët hrushovianë e hodhën në shportë Deklaratën e Mbledhjes së Partive Komuniste e Punëtore të nëntorit 1960, që të nesërmen e kësaj Mbledhjeje. Ata zbatonin në të gjitha fushat kursin e tyre revizionist dhe zhvillonin veprimtari përçarëse me forma dhe metoda të egra të presionit dhe të ndërhyrjes në punët e brendshme të vendeve socialiste dhe të partive komuniste e punëtore për t'u imponuar vijën e vet antimarksiste dhe për të organizuar një bllok kundër atyre që kundërshtonin revizionizmin.

Në këto kushte, PPSH e quante si një detyrë të saj të dorës së parë të mbronte me vigjilencë dhe të zbatonte me vazhdimësi vijën e vet të përgjithshme revolucionare, të ruante pastërtinë e marksizëm-leninizmit, të mbronte dhe të propagandonte parimet themelore marksiste-leniniste që ishin vënë në shenjë nga revizionistët.

Lufta midis marksizëm-leninizmit dhe revizionizmit zhvillohej kryesisht rreth problemeve të mëdha të zhvillimit botëror që u shtruan dhe u diskutuan në Mbledhjen e 81 Partive Komuniste e Punëtore, ku PPSH e kishte shprehur qartë qëndrimin e vet revolucionar për këto probleme. Kongresi IV e ligjësoi këtë qëndrim. Ai deklaroi se «aprovon plotësisht veprimtarinë e delegacionit të PPSH, të kryesuar nga shoku Enver Hoxha, në Mbledhjen e Moskës të 1 nëntorit 1960, si edhe dokumentet e saj historike»¹.

¹ Rezolucioni i Kongresit IV të PPSH. Dokumente kryesore të PPSH, vëll. III, f. 547.

Kongresi dënoi rreptë pikëpamjet revizioniste mbi bashkëpunimin dhe bashkëjetesën e klasave me interesa të kundërta si edhe përpjekjet e të gjithë atyre që mundoheshin ta paraqisnin epokën e sotme si një epokë qetësie dhe harmonie të përgjithshme, ku gjithë bota do të kalojë në socializëm pa revolucione, pa kryengritje dhe luftëra çlirimtare. Ai demaskoi orvatjet që bënin në mënyrë të veçantë revizionistët për asgjësimin e diktaturës së proletariatit dhe në vendet socialiste, duke theksuar se jo më zhdukja, por edhe dobësimi, liberalizimi sadopak i saj do të ishte vetëvrasje për këto vende.

Partia e Punës e Shqipërisë, orientoi Kongresi, do të mbajë kurdoherë lart flamurin e marksizëm-leninizmit e të socializmit fitimtar dhe do të vazhdojë luftën për ruajtjen e për forcimin e unitetit të lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

Që të mbrohej marksizëm-leninizmi dhe uniteti i lëvizjes komuniste ndërkombëtare, Kongresi IV i PPSH e quante të domosdoshme të bëhej një luftë e vendosur kundër revizionizmit modern, të shkatërrohej veprimtaria e tij përçarëse dhe minuese. Ai e dënoi qëndrimin e udhëheqësve të atyre partive komuniste e punëtore që kishin hequr dorë nga përcaktimi i revizionizmit si rreziku kryesor në lëvizjen komuniste ndërkombëtare dhe nga demaskimi i revizionizmit jugosllav si shprehje e përqendruar e revizionizmit modern, siç u vendos bashkërisht në Mbledhjen e Moskës. «Pa demaskuar pa mëshirë revizionizmin ... nuk mund të bëhet si duhet demaskimi i imperializmit»¹. Për të gjitha këto arsye, Kongresi porositi që «*lufta kundër revizionizmit të vazhdojë dhe të ngrihet në një nivel edhe më të lartë, deri në shkatërrimin e tij të plotë ideologjik dhe politik*. Duke luftuar me vendosmëri kundër revizionizmit si rrezik kryesor, Partia duhet të luftojë edhe kundër çdo shfaqjeje të dogmatizmit e të sektarizmit»².

Duke mbajtur një qëndrim të rreptë parimor kundër revizionizmit dhe duke demaskuar pikëpamjet revizioniste, Kongresi IV, megjithatë, nuk e kritikoi hapur udhëheqjen sovjetike për këto pikëpamje, për veprimtarinë e saj përçarëse në lëviz-

1 Enver Hoxha. Raport në Kongresin IV të PPSH. Vepra, vëll. 20, f. 283.

2 Rezolucioni i Kongresit IV të PPSH. Dokumente kryesore të PPSH, vëll. III, f. 547.

jen komuniste e në kampin socialist dhe për veprimtarinë antishqiptare. Këtë gjë PPSH e kishte bërë në Mbledhjen e Moskës, që ishte një forum i partive motra, si edhe në mbledhje të mbyllura të Komitetit Qendror e të organizatave të veta. Ajo nuk donte që mosmarrëveshjet me udhëheqjen e PKBS dhe të disa partive të tjera t'i shpallte botërisht. U përmbahej me rreptësi rregullave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis partive motra me anë të këshillimeve, siç u vendos në Mbledhjen e fundit në Moskë.

Demaskimi i pikëpamjeve antimarksiste të revizionistëve modernë nga Kongresi IV ndeshi në kundërshtimin e drejtpërdrejtë të përfaqësuesve të udhëheqjes së PKBS dhe të disa partive komuniste e punëtore të tjera që merrnin pjesë në Kongres. Duke ditur qëndrimin marksist-leninist dhe luftën e vendosur që zhvilloi delegacioni i PPSH në Mbledhjen e fundit të Moskës kundër revizionizmit modern, këta përfaqësues erdhën në Kongresin IV të PPSH me mision të posaçëm për të ushtruar presion mbi delegatët e Kongresit që këta të kundërshtonin vijën revolucionare marksiste-leniniste të Partisë së tyre dhe të dilnin në opozitë me udhëheqjen.

Për t'ia arritur këtë qëllim, në fjalimet e veta përfaqësuesi sovjetik dhe disa të tjerë ngritën teza të kundërta me ato që përmbaheshin në raportin e KQ të PPSH. Me shantazhe e me demagogji ata u munduan të detyronin edhe përfaqësuesit e partive komuniste e punëtore të tjera për të ndryshuar përmbajtjen e fjalimeve të tyre dhe për të mos përkrahur vijën e PPSH.

Delegatët e Kongresit u zemëruan thellë nga këto ndërhyrje të revizionistëve modernë. Ata iu përgjigjën këtyre ndërhyrjeve me vendosmërinë për të vazhduar më me forcë luftën për mbrojtjen e pastërtisë së marksizëm-leninizmit, për të vënë në jetë vijën politike revolucionare të PPSH dhe vendimet e Kongresit IV, duke forcuar edhe më shumë unitetin e Partisë rreth KQ me shokun Enver Hoxha në krye.

Në fund të punimeve Kongresi zgjodhi njëzëri Komitetin Qendror të PPSH prej 53 anëtarësh dhe 29 kandidatësh. Sekretar i Parë u rizgjodh Enver Hoxha.

Kongresi IV i PPSH hyri në histori si kongresi që çeli një etapë të re të zhvillimit të vendit, etapën e ndërtimit të plotë

të shoqërisë socialiste, dhe që përgatiti Partinë për një sulm të përgjithshëm ideologjik kundër revizionizmit modern.

Në Kongres u shfaq uniteti monolit marksist-leninist i radhëve të partisë dhe i vendosmërisë së saj për ruajtjen dhe forcimin e këtij uniteti nga çdo synim dhe goditje e revizionistëve modernë. Kjo u shpreh me forcë të madhe në diskutimet me përmbajtje të shëndoshë e me frymë të thellë luftarake dhe në pranimin njëzëri të raporteve, të rezolucionit, të direktivave për planin e 3-të pesëvjeçar dhe në zgjedhjen me vota të njëzëshme të organeve të larta udhëheqëse të Partisë.

2. PARTIA NË LUFTË PËR PLOTËSIMIN E DETYRAVE TË PLANIT TË TRETË PESËVJEÇAR. SHKATËRRIMI I SYNIMEVE ARMIQËSORE TË REVIZIONISTËVE KUNDËR RPSH

Klasa punëtore, fshatarësia kooperativiste dhe inteligjencia popullore i përqaftuan menjëherë vendimet e Kongresit IV të Partisë dhe u mobilizuan me të gjitha forcat për t'i vënë në jetë. Fryma e thellë revolucionare e punimeve dhe e vendimeve të Kongresit ngjallën një entuziazëm të madh te masat e gjera punonjëse në luftën për të kapërcyer vështirësitë e pengesat dhe për të plotësuar detyrat e planit të ri pesëvjeçar.

Forcimi i regjimit të kursimit

Për të plotësuar detyrat e planit Partia e përqëndroi vëmendjen në përdorimin sa më mirë të të gjitha vlerave materiale e financiare, në vendosjen e një regjimi të rreptë kursimi në ekonominë popullore dhe në gjithë veprimtarinë shtetërore e shoqërore të vendit.

Regjimi i kursimit, si metodë drejtimi në ekonominë socialiste, buron nga mënyra socialiste e prodhimit. Shndërrimi socialist i ekonomisë kombëtare, krijimi i pronës socialiste në qytet e në fshat kishin bërë të mundur që sfera e veprimit të regjimit të kursimit të zgjerohej, që rezervat e brendshme të zbuloheshin e të shndërroheshin në burime plotësuese për zhvillimin e ekonomisë e të kulturës. Nga ana tjetër, shfrytëzimi sa më mirë i rezervave të brendshme ndihmonte drejtpërdrejt në kapërcimin e vështirësive që rridhnin nga rrethimi kapitalisto-revizionist i vendit.

Veç kësaj, Partia parashikonte se në të ardhmen grupi i Hrushovit dhe pasuesit e tij do të dendësonin veprimtarinë e tyre minuese kundër Shqipërisë socialiste. Kjo e bënte edhe më të domosdoshme përdorimin në një shkallë më të gjerë dhe më me ekonomi të burimeve, forcave dhe mjeteve të brendshme.

Këtë problem kaq të rëndësishëm PPSH e shtroi përpara masave punonjëse për të marrë mendimin krijues të tyre dhe për ta bërë atë një problem të të gjithë popullit. Në këshillimin e gjerë popullor që u organizua në qershor të vitit 1961, kolektivat punonjëse të ndërmarrjeve bënë propozime konkrete e shumë të vlefshme për rritjen e prodhimit pa shpenzime plotësuese. Kudo u përhap iniciativa për të punuar tre muaj në vit me rezervat e brendshme, pa përdorur pjesë këmbimi dhe materiale importi. Si pasojë e uljes së kostos, e shkurtimit të investimeve të panevojshme e të parakohshme dhe e masave të tjera u kursye një shumë e atillë që përbënte më se 6 për qind të buxhetit të shtetit.

Këshillimi popullor mbi regjimin e kursimit tregoi ngritjen në një shkallë më të lartë të pjekurisë politike dhe të patriotizmit socialist të popullit shqiptar, gatishmërinë e tij për t'iu përgjigjur momentit politik. Ai tregoi gjithashtu domosdoshmërinë për një kujdes më të madh në hartimin e planeve ekonomike nga ndërmarrjet dhe institucionet shtetërore në mënyrë që të zbuloheshin dhe të shfrytëzoheshin më mirë mundësitë e zhvillimit të ekonomisë popullore.

Komiteti Qendror i Partisë analizoi përfundimet dhe bëri përgjithësimin e këtij këshillimi popullor. Mbi këtë bazë ai vuri detyrë të tregojë veçanërisht kujdes në kursimin e materialeve të prodhimit nëpërmjet përdorimit më racional të tyre, zëvendësimit të lëndëve të para e të materialeve të tjera të importit me të vendit, pa dëmtuar cilësinë. Kursime të rëndësishme do të bëheshin duke siguruar procesin e pandërprerë të prodhimit, përdorimin sa më të plotë të makinerive e të pajisjeve, shfrytëzimin racional të kohës së punës, pakësimin e shpenzimeve në sferën joproduuese, shtimin e të ardhurave nga eksporti.

Mundësi të gjera për kursim dhe rezerva të shumta kishte edhe në lëmin e investimeve. Për këtë institucionet shtetërore përkatëse detyroheshin të bënin studime të plota për të për-

caktuar drejt leverdishmërinë ekonomike të veprave të reja që do të ndërtoheshin, pa lënë pas dore rëndësinë politike të tyre.

PPSH përballë sulmit të egër të udhëheqjes revizioniste sovjetike

Partia dhe masat punonjëse porsa kishin filluar nga plotësimi i detyrave të planit të 3-të pesëvjeçar, kur udhëheqja sovjetike u hodh në sulm të përgjithshëm kundër RPSH në lëmin politik dhe ekonomik, duke i shtrirë mosmarrëveshjet ideologjike edhe në fushën e marrëdhënieve shtetërore.

Qeveria sovjetike prishi në mënyrë të njëanshme të gjitha marrëveshjet e përfunduara rregullisht midis dy vendeve. Ajo ndërpreu plotësisht kreditë që detyrohej, në bazë të marrëveshjeve, t'i jepte RP të Shqipërisë gjatë viteve 1961-1965, preu çdo marrëdhënie tregtare, tekniko-shkencore e kulturore. Ajo tërhoqi nga Shqipëria në formë të bujshme e kërcënuese të gjithë specialistët sovjetikë.

Këto veprime antimarksiste, antishqiptare u shoqëruan me një letër të saj drejtuar, në prill 1961, qeverisë së RPSH. Në këtë letër, midis të tjerave, thuhej se Shqipëria «nuk mund të shprejsojë më tutje që Bashkimi Sovjetik ta ndihmojë atë mbi bazën e mëparshme, ndihmë të cilën kanë të drejtë ta marrin vetëm miqtë dhe vëllezërit e vërtetë!». Me fjalë të tjera, udhëheqja revizioniste sovjetike shpallte hapur, atë që zbatonte në praktikë, se kishte hequr dorë nga marrëdhëniet vëllazërore të ndihmës midis vendeve socialiste. Fill pas kësaj, në maj, ajo prishi arbitrarisht marrëveshjet dypalëshe në fuqi mbi detyrimet që kishte marrë në përputhje me Traktatin e Varshavës, duke prerë krejt dërgimin e armatimeve dhe të teknikës tjetër të nevojshme për Ushtrinë Popullore Shqiptare. Ajo tërhoqi para syve të gjithë botës anijet e bazës detare luftarake të Vlorës dhe i grabiti Shqipërisë 8 nëndetëse si edhe luftanijet shqiptare që ndodheshin për riparim në Sevastopol. Këto veprime dobësonin fuqinë mbrojtëse të RPSH dhe të kampit socialist, nxitnin shumë lakmitë e imperialistëve amerikanë, të monarkofashistëve grekë dhe të revizionistëve komplotistë jugosllavë.

Megjithatë, PPSH nuk i dënoi botërisht këto veprime armiqësore të klikës së Hrushovit. Përkundrazi, KQ i PPSH

edhe në korrik 1961 i shkruante KQ të PKBS: «duhet të hiqet dorë nga shtrirja e mosmarrëveshjeve ideologjike, që ekzistojnë midis dy partive tona, në fushën e marrëdhënieve shtetërore, qoftë në lëmin ekonomik, qoftë në atë politik e ushtarak»¹.

Por revizionistët hrushovianë s'e përfillën këtë kërkesë as e ndalën sulmin e tyre armiqësor kundër Partisë dhe popullit shqiptar. Ata prishën marrëveshjen mbi arsimimin e qytetarëve të RPSH në shkollat e Bashkimit Sovjetik, u prenë bursën gjithë studentëve të rregullt shqiptarë, civilë e ushtarakë, dhe i dëbuan nga Bashkimi Sovjetik. Që prej kësaj kohe, ata e përjashtuan në fakt RPSH nga Traktati i Varshavës, pa përfillur sovranitetin e popullit shqiptar. Prandaj edhe i mohuan delegacionit të plotfuqishëm të PPSH të kryesuar nga shoku Ramiz Alia, sekretar i KQ, të drejtën për të marrë pjesë në mbledhjen e përfaqësuesve të partive komuniste e punëtoresh të vendeve të Traktatit të Varshavës, që u mbajt në gusht 1961 në Moskë.

Në këtë mënyrë revizionistët hrushovianë organizuan një bllokadë të egër ekonomike, politike dhe ushtarake kundër Shqipërisë socialiste, duke e shoqëruar bllokadën me një veprimtari të gjithanshme armiqësore të hapur dhe të fshehtë kundër saj. Me këtë, ata kishin qëllim të krijonin një gjendje pasigurie në RPSH, të detyronin Partinë e Puaës dhe popullin shqiptar të gjunjëzoheshin, të largoheshin nga rruga marksiste-leniniste dhe të përqaфонin kursin revizionist.

Ky qëllim i revizionistëve hrushovianë u duk edhe më mirë në Kongresin XXII të PKBS që u mbajt në tetor 1961. N. Hrushovi, duke shkëlur brutalisht deklaratat e Moskës të viteve 1957 dhe 1960, rregullat më elementare në marrëdhëniet midis partive komuniste e punëtoresh motra, sulmoi botërisht me shpifje e padi nga më të ulëtat Partinë e Punës të Shqipërisë. Në raportin që mbajti përpara Kongresit, ai arriti deri atje sa ta quajë udhëheqjen e PPSH «agjente të imperializmit» «të shitur për 30 aspra» dhe t'u bëjë thirrje komunistëve dhe popullit shqiptar për kundërrevolucion!

1 Letër e KQ të PPSH dhe e Këshillit të Ministrave të RPSH drejtuar KQ të PK të BS. 6 korrik 1961. Dokumente kryesore të PPSH, vëll. IV, f. 60.

Udhëheqja revizioniste sovjetike synonte të ngrinte njëzëri kundër PPSH të gjithë delegatët e Kongresit dhe të gjithë përfaqësuesit e partive komuniste e punëtore të botës. Por ajo nuk ia arriti dot këtij qëllimi. Mjaft përfaqësues të partive të tjera dhe një numër i madh i delegatëve që morën fjalën nuk u shprehën për këtë qëndrim antimarksist të saj.

Ndërkaq, Çu En Lai që kryesonte delegacionin kinez në kongresin sovjetik e kritikoi sulmin e hapur kundër PPSH, por ai kritikoi vetëm metodën që përdori Hrushovi për të nxjerrë në shesh përpara armikut mosmarrëveshjet midis partive, kurse s'tha as një fjalë në mbrojtje të qëndrimeve e të vijës së drejtë të PPSH. Ndërkaq, kërkoi të shuhej polemika në një kohë kur grupi revizionist i Hrushovit kishte sulmuar egërsisht PPSH, që mbronte me vendosmëri marksizëm-leninizmin. Përsëri i polemikës në ato rrethana vetëm i sillte dobi revizionizmit modern. Ky qëndrim i Çu En Lait tregonte se udhëheqja kineze lëkundej, nuk ishte për një luftë të vendosur pa-ri more kundër revizionizmit hrushovian.

Duke nxjerrë në shesh botërisht në mënyrë të njëanshme mosmarrëveshjet dhe duke shpallur hapur sulmin kundër PPSH, grupi i Hrushovit u dha armë në dorë armiqve dhe mori kështu mbi vete një përgjegjësi historike si përçarës i unitetit të kampit socialist dhe të lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

PPSH në luftë të hapur me udhëheqjen revizioniste sovjetike

Në këto kushte, PPSH nuk mund të heshtte. Ajo jo vetëm që kishte plotësisht të drejtë, por kishte edhe detyrë të bënte të njohur botërisht pikëpamjen e vet, të vinte në dijeni lëvizjen komuniste dhe opinionin publik ndërkombëtar mbi të vërtetën në marrëdhëniet midis PPSH dhe udhëheqjes revizioniste sovjetike, mbi veprimtarinë armiqësore antishqiptare të kësaj udhëheqjeje.

Nëpërmjet fjalimit që mbajti shoku Enver Hoxha më 7 nëntor 1961, me rastin e 20-vjetorit të themelimit të PPSH, dhe të 44-vjetorit të Revolucionit Socialist të Tetorit, PPSH u bëri një analizë të thellë marksiste-leniniste marrëdhënies shqiptaro-sovjetike dhe nxori në shesh me argumente se shkak i acarimit të tyre ishte politika antimarksiste e shoviniste prej shteti të madh e Hrushovit me grupin e tij revizionist. Ky

grup kishte tradhtuar marksizëm-leninizmin dhe politikën tradicionale që Partia Bolshevike dhe qeveria sovjetike patën ndjekur me vazhdimësi nën udhëheqjen e V.I. Leninit dhe të J. Stalinit.

Gjatë 20 vjetëve të jetës së saj, PPSH kishte luftuar pa pushim për forcimin e miqësisë midis popullit shqiptar dhe popullit sovjetik, për vendosjen e lidhjeve sa më të ngushta midis RPSH dhe BRSS. Ajo i kishte edukuar komunistët dhe popullin shqiptar me besnikëri dhe me dashuri të pakufishme ndaj partisë së madhe të Lenin-Stalinit dhe shtetit të parë socialist. Përvoja e PKBS kishte qenë një burim frymëzimi dhe mësimi në revolucionin popullor dhe në ndërtimin socialist. RPSH kishte marrë ndihma të rëndësishme internacionaliste, sido që jo të mjaftueshme, nga Bashkimi Sovjetik. Deri në verë të vitit 1960 bashkëpunimi midis dy partive e dy vendeve kishte qenë përgjithësisht normal, pavarësisht nga mospajtimi e kundërshtimet e PPSH për një varg pikëpamjesh e vepri-mesh të gabuara të grupit të Hrushovit.

Duke shprehur dëshirën dhe vendosmërinë e Partisë dhe të gjithë popullit shqiptar, shoku Enver Hoxha theksoi se edhe në të ardhmen në Shqipëri do të ruheshin të paprekura ndjenjat e pastra të miqësisë me popujt sovjetikë. Por në të njëjtën kohë, PPSH nuk do të pajtohej në asnjë mënyrë me kursin revizionist të grupit të Hrushovit, nuk do të pranonte të hiqte dorë nga pikëpamjet dhe bindjet e veta marksiste-leniniste dhe nuk do t'i nënshtrohej diktatit hrushovian.

PPSH shikonte në udhëheqjen hrushoviane jo vetëm një armik të saj in e të gjithë popullit shqiptar, por në radhë të parë një armik të marksizëm-leninizmit dhe të vetë Bashkimit Sovjetik.

Shoku Enver Hoxha vuri në dukje se kriteri i besnikërisë ndaj mësimëve të marksizëm-leninizmit dhe të internacionalizmit proletar, i dashurisë ndaj Bashkimit Sovjetik nuk është qëndrimi ndaj Kongresit XX a ndaj programit që aprovoi Kongresi XXII i PKBS. Vendimet e kongreseve të një partie janë të detyrueshme vetëm për anëtarët e saj. Partitë komuniste e punëtorë janë të barabarta dhe të pavarura. Ato përpunojnë politikën e vet duke u nisur nga kushtet konkrete të vendeve të tyre dhe duke u mbështetur në mësimet e marksizëm-leninizmit. Orvatjet e revizionistëve hrushovianë për t'i paraqitur tezat oportuniste të Kongresit XX si norma ndërkombëtare,

të detyrueshme për të gjitha partitë komuniste e punëtores, nuk kishin asgjë të përbashkët me mësimet e marksizëm-leninizmit dhe ishin një shkelje e drejtpërdrejtë e parimit të barazisë dhe të pavarësisë së partive marksiste-leniniste.

Në të njëjtën kohë, Komiteti Qendror i PPSH i bëri edhe një herë thirrje Komitetit të ri Qendror të PKBS, që zgjodhi Kongresi XXII i saj, të analizonte me objektivitet dhe drejtësi leniniste gjendjen e rëndë në marrëdhëniet sovjeto-shqiptare, që kishte krijuar veprimtaria antimarksiste e grupit të Hrushovit, dhe të merrte masat e nevojshme për normalizimin e këtyre marrëdhënieve ¹.

Kësaj kërkesë të çiltër shoqërore grupi revizionist i Hrushovit iu përgjigj me një veprim tjetër armiqësor, të pashëmbull në marrëdhëniet midis vendeve socialiste, me prerjen e marrëdhënieve diplomatike me Republikën Popullore të Shqipërisë. Si shkas për këtë veprim ai përdori trillimin se gjoja «qeveria shqiptare ka shpërthyer në vendin e saj një fushatë shpifëse dhe armiqësore kundrejt BRSS», se «ajo po zbaton me paramendim masa që synojnë të pengojnë veprimtarinë normale të Ambasadës dhe të Përfaqësisë Tregtare të BRSS në Shqipëri» etj. Në të vërtetë ky akt dëshmonte për dështimin e përpjekjeve të udhëheqësve sovjetikë për ta detyruar PPSH të hiqte dorë nga lufta parimore që ajo i bënte kursit të tyre revizionist, orvatjeve të tyre për t'ia imponuar asaj këtë kurs me çdo kusht.

Duke filluar luftën e hapur kundër revizionizmit hrushovian, PPSH merrte çdo përgjegjësi, si përpara popullit shqiptar ashtu dhe përpara lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Këtë luftë ajo e filloi me bindje se do të dilte fitimtare, për arsye se mbronte një çështje të drejtë, çështjen e marksizëm-leninizmit, çështjen e socializmit, për arsye se bashkë me të luftonin komunistët dhe gjithë forcat revolucionare të botës. Njëkohësisht, për të zhdukur çdo ide të rreme, që mund të krijohej për një fitore të lehtë e të shpejtë, Komiteti Qendror paralajmëroi se «lufta që po u imponohet Partisë dhe popullit

¹ Letër e KQ të PPSH drejtuar KQ të PK të BS, miratuar në mbledhjen e Plenumit më 12 tetor 1961 dhe dorëzuar Ambasadës së BRSS në Tiranë më 11 nëntor 1961. Dokumente kryesore të PPSH, vëll. IV, f. 151.

tonë do të jetë e gjatë dhe e vështirë. Por vështirësitë nuk e kanë trembur kurrë Partinë dhe popullin tonë»¹.

Uniteti i çeliktë i popullit rreth Partisë në luftë kundër revizionistëve hrushovianë

Me prerjen e marrëdhënieve diplomatike dhe bllokadën ekonomike, revizionistët hrushovianë kujtonin se Shqipëria do të veçohet krejt dhe

më në fund do të gjunjëzohet, meqenëse është një vend i vogël dhe, si i tillë, nuk do t'i bënte dot ballë presionit. Për Shqipërinë, mendonin revizionistët sovjetikë, mbeteshin dy rrugë: ose të pranonte kursin antimarksist të Kongresit XX dhe XXII e t'i nënshtrohej diktatit të tyre ose të hidhej në prehrin e imperializmit. Ata bënë llogari tepër të gabuara dhe shpresonin që populli shqiptar, i shtyrë nga dashuria për Bashkimin Sovjetik, do të ngrihej kundër udhëheqjes revolucionare të Partisë e të shtetit të vet.

Revizionistët hrushovianë synonin gjithashtu t'u jepnin një mësim vendeve të tjera të demokracisë popullore dhe t'u tregonin që, po të mos i nënshtroheshin diktatit të tyre, ata do të merrnin të njëjtat masa.

Veprimtaria armiqësore e grupit të N. Hrushovit në të gjitha drejtimet, në lëmin ekonomik, ushtarak, politik e kulturor i solli dëme të mëdha popullit shqiptar. Kreditë që duhej t'i jepeshin Republikës Popullore të Shqipërisë në bazë të marrëveshjeve të rregullta me qeverinë sovjetike zinin një peshë të rëndësishme në investimet e planit të 3-të pesëvjeçar. Prerja e plotë e këtyre kredive vinte në pikëpyetje ndërtimin e një numri veprash të rëndësishme të këtij plani. Vëllimi i eksport-importit me Bashkimin Sovjetik për 12 vjet me radhë kishte përbërë 50 për qind të qarkullimit të përgjithshëm të tregtisë së jashtme. Prerja e plotë e marrëdhënieve tregtare nga qeveria sovjetike krijonte vështirësi të mëdha për eksportimin e mallrave shqiptare dhe për importimin e makinerive dhe të sendeve të tjera shumë të nevojshme për zhvillimin e ekonomisë popullore. Përveç kësaj, qeveria shqiptare, nga

¹ Deklaratë e KQ të PPSH, 20 tetor 1961. Dokumente kryesore të PPSH, vëll. IV, f. 154.

prerja e ndihmës ushtarake, ishte e detyruar të rëndonte jashtë mase ekonominë e vendit për të forcuar mbrojtjen e atdheut.

Në këto kushte të rënda, fuqitë imperialiste, nga ana e tyre, shpresuan se kishte ardhur koha që ta tërhiqnin Shqipërinë në kampin imperialist. Për këtë qëllim, ata nuk vonuan t'i ofronin asaj kredi dhe të shprehnin gatishmërinë për plotësimin e kërkesave të ndryshme që do të vinin nga ajo!

Por, si revizionistët hrushovianë, ashtu dhe imperialistët gabuan rëndë në llogaritë dhe shpresat e tyre. Shoku Enver Hoxha në fjalimin e tij të 7 Nëntorit 1961 i kishte shprehur shumë qartë ndjenjat dhe vendosmërinë e popullit për të ecur përpara në rrugën e socializmit pa u trembur nga vështirësitë dhe pengesat. «...Populli shqiptar dhe Partia e tij e Punës, — theksonte ai, — do të rrojnë edhe me bar po të jetë nevoja, por kurrë nuk do të shiten «për 30 aspra», se ata preferojnë më mirë të vdesin në këmbë e me nder se sa të rrojnë me turp e të gjunjëzuar»¹.

Thirrjes së revizionistëve hrushovianë për të përmbysur udhëheqjen e Partisë dhe të shtetit, sulmeve, presioneve dhe shantazheve të tyre, komunistët shqiptarë dhe masat e gjera të punonjësve iu përgjigjën duke dëndësuar luftën për plotësimin e detyrave të planit dhe duke shtrënguar edhe më shumë radhët rreth Partisë e Komitetit Qendror të saj. Uniteti i çeliktë i popullit me Partinë u ngrit në një shkallë edhe më të lartë.

Me gjithë vështirësitë e krijuara nga prerja e kredive dhe tërheqja e specialistëve sovjetikë, në përgjithësi u sigurova vazhdimi i punimeve në veprat në ndërtim; plani i vitit 1961 u plotësua, prodhimi industrial u tejkalua, prodhimi bujqësor u rrit 22 për qind në krahasim me një vit më parë.

Këto përfundime bënë të mundur që, me gjithë kushtet e vështira të bllokadës, të mos prekej niveli i jetesës së popullit. Sipas planit, në tetor 1961, u bë një ulje e re e çmimeve të shitjes me pakicë të mallrave industriale në masën e parashikuar.

Detyrë shumë e madhe për Partinë dilte të sigurohej edhe plotësimi i planeve të viteve të tjera të pesëvjeçarit. Për t'ia

1 Enver Hoxha. Vepra, vëll. 22, f. 127.

arritur këtij qëllimi, asaj i duhej të kapërcente vështirësi të shumta e të mëdha.

Këto vështirësi u shtuan edhe më tepër në vitin 1962 pas prerjes së kredive edhe nga qeveritë e disa vendeve të demokracisë popullore të Evropës që ndiqnin kursin dhe shembullin e qeverisë sovjetike. Megjithëse këto qeveri nuk i prenë krejt marrëdhëniet ekonomike me RPSH, siç bëri grupi i N. Hrushovit, me qëllime të caktuara zvarrisën për një kohë të gjatë lidhjen e marrëdhënieve tregtare dhe kundërshtuan të shkëmbenin mallra të eksportit shqiptar me mallrat e tyre shumë të nevojshme për zhvillimin e ekonomisë shqiptare.

Në këto kushte të bllokadës dhe të presioneve të ndryshme të revizionistëve modernë, mbështetja në forcat e veta merre një kuptim edhe më të madh politik. Dilte e domosdoshme të forcohej në popull edhe më shumë optimizmi revolucionar, besimi i patundur në forcat dhe aftësitë e tij krijuese, bindja e thellë se ai mund të luftojë, të punojë dhe të ndërtojë me sukses socializmin, të arrijë fitore në çdo situatë, sado e ndërlikuar të jetë ajo.

Për gjendjen e krijuar, për vështirësitë e mëdha që duheshin kapërcyer në zbatimin e detyrave të ndërtimit socialist, të zhvillimit ekonomik e kulturor e të mbrojtjes Partia u këshillua me masat popullore.

Duke iu përgjigjur thirrjes së Partisë, klasa punëtore, fshatarësia kooperativiste, inteligjencia, rinia u përfshinë në një lëvizje të gjerë patriotike revolucionare për të mos lënë pa plotësuar asnjë detyrë. Masat luftonin njëkohësisht tok me Partinë kundër revizionizmit hrushovian dhe revizionizmit modern në përgjithësi për të mbrojtur marksizëm-leninizmin, për të zbatuar vijën e Partisë.

Uniteti i pathyeshëm i popullit me Partinë në veprimin revolucionar për plotësimin e detyrave, në luftën kundër imperializmit e revizionizmit u shfaq me të gjithë forcën në zgjedhjet e 3 qershorit 1962 për Kuvendin Popullor, në të cilat morën pjesë dhe votuan gati 100 për qind e votuesve për kandidatët e Frontit Demokratik, për vijën marksiste-leniniste të Partisë.

Në rrethanat e bllokadës imperialisto-revizioniste një karakter gjithashtu më të mprehtë merrnin përgatitja e kuadrit e ngritja tekniko-profesionale e punonjësve. Komiteti Qendror i Partisë i shqyrtoi në një mbledhje të posaçme të Plenumit të

tij këto probleme të rëndësishme për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste. U morën masa për të përgatitur 118 mijë punëtorë të kualifikuar gjatë pesëvjeçarit, si edhe për të rritur nivelin arsimor të punëtorëve në përgjithësi në përshtatje me kërkesat e teknikës së përparuar. Një kujdes i posaçëm u tregua për një aftësim më të madh e për rritjen e rolit të teknikëve të mesmë. Gjithashtu u përmirësua puna për përgatitjen, kualifikimin e mëtejshëm dhe specializimin e kuadrove të lartë. Një numër më i madh specialistësh u tërhoqën në punën kërkimore-shkencore.

Në të njëjtën kohë u forcua puna për kalitjen ideologjike revolucionare të kuadrove dhe të specialistëve të të gjitha degëve. Kjo ndihmoi që intelektualët dhe gjithë kuadrot të thellojnë bindjet revolucionare marksiste-leniniste, të merrnin pjesë më gjallërisht në luftën kundër ndikimit të ideologjisë borgjeze dhe teorive oportuniste e revizioniste.

Puna ideologjike e Partisë dhe veprimi revolucionar zhvilluan më tej te të gjithë punonjësit shpirtin e sakrificës e të vetëmohimit, vendosmërinë në kapërcimin e vështirësive.

Krahas luftës për plotësimin e detyrave ekonomike të planit të 3-të pesëvjeçar, PPSH i kushtoi një kujdes shumë të madh rritjes së fuqisë mbrojtëse të vendit dhe krijimit të rezervave shtetërore për t'i bërë ballë çdo situatë, çdo të papriturë.

3. DETYRAT PËR ZHVILLIMIN E MËTEJSHËM TË BUJQËSISË SOCIALISTE

Problemi i fshatit, i zhvillimit të tij mbetet gjithnjë një problem shumë i rëndësishëm.

Në vitet pas Çlirimit bujqësia kishte pësuar ndryshime të mëdha. Më 1961 prodhimi i përgjithshëm bujqësor ishte dyfishuar në krahasim me vitin 1938.

Në etapën e parë të ndërtimit socialist PPSH ndoqi kryesisht politikën e zhvillimit në gjerësi të bujqësisë. Në atë kohë ajo nuk mund të vepronte ndryshe, sepse mungonin mjetet e mekanizuara, sistemi i bonifikimit dhe i vaditjes, kuadrot e kualifikuar, plehrat kimike etj. Deri në vitin 1961, 62 për qind e rritjes së përgjithshme të prodhimeve bujqësore kishte rrjedhur nga zgjerimi i sipërfaqes së punueshme të to-